



2025 RAPORTI VJETOR

Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile



04 22 355 69

www.amshc.gov.al

Rruga "Frosina Plaku", Nr. 58, Kati II,
Tiranë, Shqipëri



TABELA E PËRMBAJTJES

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT EKZEKUTIV Z.ANDI KANANAJ.....	3
---	---

KAPITULLI I

· Vështrim i përgjithshëm.....	4
· Organet dhe funksionet e institucionit	5
· Kuadri ligjor oranizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së.....	6

KAPITULLI II

· Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" ,Ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik si dhe Strategjisë Kundër Korrupsionit.....	7
· Statistika lidhur me Nr total të Projekteve Propozime të ardhura (OJF-te qe kane aplikuar) si dhe shpërndarja e tyre sipas secilës fushë prioritare	8-16
· Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese	16-18

KAPITULLI III

· Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)	19-20
--	-------

KAPITULLI IV

· Monitorimi/Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2025	
· Plani fillestar i Buxhetit Viti 2025	21-24
· Rishikimi i Buxhetit	
· Vitin 2025 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar	25
· Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2025.....	33

KAPITULLI V

· Aktivitetet kryesore të AMShC-së për vitin 2025	34-45
---	-------

KAPITULLI VI

· Bordi Mbikqyrës	46-47
-------------------------	-------

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT EKZEKUTIV Z.ANDI KANANAJ

Të nderuar,

Në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Mbështetjes së Shoqërisë Civile, në bazë të kompetencave dhe detyrave që më janë caktuar si rrjedhojë e ligjit Nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në vazhdimësi të ecurisë të punës së kryer gjatë vitit kalendarik 2025 dua të theksoj disa nga arritjet kryesore të Angazhimit të AMSHC-së.

Në vazhdimësi të strategjive Ndërsektoriale Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile ka pasur Rolin kryesor në kontributin e saj për nisma në dobi të Shoqërisë Civile të tilla si Lufta Kundër-Korrupsionit, në zbatimin e strategjisë kombëtare kundër ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit, Kontributi i AMSHC-se në kuadër të monitorimit periodik të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030; dhe Planit Veprimit " Strategjia për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit" 2024-2030, Barazia gjinore dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje në kuadër të Raportit Kombëtar mbi zbatimin e Deklaratës dhe platformës për Veprim Pekin +30; Raportit Monitorimit për indikatorët e zbatimit të “Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjet të Romëve dhe Egjiptianëve ” si dhe Paketës Semestrale për Integrimin Evropian (PSIE).

Gjatë këtij viti, përmes Thirrjes Nr. 18, financuam 75 projekte nga 160 aplikime, duke alokuar një fond prej 107,600,000 lekësh në fusha prioritare si qeverisja e mirë, antikorrupsioni, përfshirja sociale, zhvillimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i kulturës dhe arsimit. Këto projekte kanë kontribuar drejtpërdrejt në fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare.

AMSHC vazhdon të mbetet e përkushtuar ndaj parimeve të barazisë gjinore, zhvillimit të qëndrueshëm dhe integritetit evropian. Mbështetja për iniciativa që promovojnë demokracinë, sundimin e ligjit të cilat mbeten prioritet edhe në vitet në vijim.

Duke falënderuar të gjithë partnerët, organizatat përfituese dhe institucionet bashkëpunuese për besimin dhe kontributin e tyre, shprehim angazhimin tonë për të vijuar me profesionalizëm, integritet dhe vizion në shërbim të shoqërisë civile shqiptare.

Sinqerisht,

Andi Kananaj
Drejtor Ekzekutiv

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është një ent publik, buxhetor krijuar me Ligjin me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

AMShC-ja është krijuar me qëllimin për të asistuar me mbështetje financiare dhe teknike shoqërinë civile në vend duke qenë e përkushtuar të promovojë, mbështesë dhe mbrojë parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencës dhe profesionalizmit.

Një shoqëri civile aktive, e fuqishme dhe gjithë përfshirëse mund të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin në praktikë të këtyre parimeve. Ajo është gjithashtu një komponent thelbësor i çdo demokracie funksionale.

Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile, si subjekte jo- shtetërore, struktura jo-fitimprurëse, në të cilat njerëzit organizohen të ndjekin objektivat dhe idealet e përbashkëta, duhet të jenë gjithnjë e më shumë aktive për çështje publike si dhe të angazhohen në iniciativa që nxisin pluralizmin dhe pjesëmarrjen në demokraci.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në kuadër të politikës së fuqizimit të shoqërisë civile, është përqendruar në stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe gjithë përfshirëse.

Kjo reflektohet në përpjekjet për krijimin e një mjedisi që është i favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve për të qenë aktorë të efektshëm, të përgjegjshëm dhe të pavarur, nëpërmjet formalizmit të procedurave transparente dhe jo- diskriminuese të regjistrimit, veprimtarisë së lirë dhe të pavarur, si dhe bashkëpunimit midis qytetarëve etj.

Shoqëria civile, duke pasur struktura të përshtatshme dhe mekanizma për bashkëpunim me AMShC-në dhe institucionet e tjera publike, si dhe fluks të lirë, të qartë dhe të arritshme të informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të qëndrueshme dhe të strukturuar, rrit autonominë e saj, atë të përfaqësimit dhe të llogaridhënies, duke forcuar bazën e organizatave sipas standardeve më të larta të qeverisjes së brendshme, nëpërmjet përfshirjes së strukturave demokratike, monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar, transparençës, informimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Organet dhe funksionet e institucionit

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është krijuar me Ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe ka si mision të saj, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut. Për përmbushjen e këtij misioni, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si detyrë të saj funksionale që të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse; bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar; nismat civile; filantropi; vullnetarizmin e institucioneve demokratike të shoqërisë civile; si dhe programe të tjera, që lehtësojë përmbushjen e misionit të saj.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- nxitjen e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit; luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj; kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;
- nxitjen e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;
- respektimin e të drejtave të njeriut;
- krijimin e konsolidimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;
- zhvillimin e bashkëpunimit ndër sektorial dhe e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;
- rritjen e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje;
- zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;
- rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike
- përcaktimin e procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile etj

Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMSHC-së

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile funksionon dhe mbështet punën e saj duke u bazuar në një paketë të plotë ligjore, si vijon:

a) Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ky ligj, deri më sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

b) Vendimi nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

c) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës.

d) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile” të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës me Vendimin nr. 1 datë 19/02/2024

e) Udhëzimin nr. 1 datë 29.12.2010 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt të monitorimit të Projekteve të financuara me Grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

f) Urdhri nr. 161 datë 05.09.2013 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për procedurën e administrimit të akteve shkresore, kërkesave/projekt-propozimeve, formimin e dosjeve dhe mënyra e qarkullimit të tyre në AMSHC”.

KAPITULLI II

ANALIZA E SHPËRNDARJES SË GRANTEVE - THIRRJA NR. 18 (2025); ZBATIMI I POLITIKAVE NDËRSEKTORIALE, TRANSPARENCA INSTITUCIONALE.

2.1 Roli Institucional i AMSHC dhe Objektivat për Vitin 2025

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), si institucion publik qendror buxhetor, gjatë vitit 2025 ka vijuar ushtrimin e funksioneve të saj në përputhje me Ligjin nr. 10093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, duke ruajtur fokusin strategjik në mbështetjen financiare të sektorit të shoqërisë civile, forcimin e partneritetit institucional dhe rritjen e impaktit social të projekteve të financuara.

Veprimtaria institucionale për vitin raportues është orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së proceseve të financimit, garantimit të transparencës administrative, zgjerimit të mbulimit territorial të ndërhyrjeve të mbështetura, si dhe përputhjes së programeve të grantit me prioritetet kombëtare të zhvillimit dhe integrimit evropian.

Në këtë kuadër, AMSHC ka synuar të kontribuojë në fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile si aktorë kyç në proceset e zhvillimit lokal, monitorimit të politikave publike, ofrimit të shërbimeve sociale dhe rritjes së pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.

2.2 Zbatimi i Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, AMSHC ka vijuar gjatë vitit 2025 zbatimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës si një instrument thelbësor për garantimin e aksesit të publikut në informacion dhe forcimin e besimit publik ndaj institucionit.

Programi i transparencës përcakton kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë, procedurat për trajtimin e kërkesave për informacion, strukturat përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit dhe afatet kohore për publikimin e informacionit.

Gjatë vitit raportues, AMSHC ka siguruar publikimin e vazhdueshëm të informacionit mbi strukturën organizative, aktet normative dhe administrative, procedurat e financimit me grante, dokumentacionin buxhetor dhe financiar, si dhe vendimmarrjet e Bordit Mbikëqyrës.

Faqja zyrtare e internetit e AMSHC-së ka shërbyer si kanali kryesor i komunikimit institucional me publikun, duke garantuar akses të hapur, përditësim të vazhdueshëm dhe format të kuptueshëm të informacionit.

2.3 Zbatimi i Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

Në zbatim të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, AMSHC ka zhvilluar gjatë vitit 2025 procese të strukturuar konsultimi publik me aktorët e shoqërisë civile dhe palët e interesuara.

Takimet informuese dhe konsultative janë fokusuar në përcaktimin e prioritetëve të Thirrjes Nr. 18 për Projekt-Propozime, informimin mbi kriteret e aplikimit dhe procedurat e vlerësimit, si dhe identifikimin e nevojave emergjente të komuniteteve lokale.

Procesi i konsultimit publik ka kontribuar në rritjen e transparencës së vendimmarrjes, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe përmirësimin e cilësisë së programeve mbështetëse të AMSHC-së.

ANALIZA DHE STATISTIKA TË SHPËRNDARJES SË GRANTEVE TË THIRRJES 18 SIPAS FUSHAVE PRIORITARE SI DHE SHTRIRJES TERRITORIALE

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut; shpalli këtë Thirrje për Shprehje Interesi; Thirrjen e rradhës për të gjitha OJF-të e interesuara për projekte.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), është pjesë e zbatimit të Objektivave të Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 – 2030

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) AMSHC-ja ka fut si prioritet të dedikuar Prioritin :Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI: detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahe)

Ky prioritet është në kuadër pikërisht në kuadër të detyrimeve që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

Prioritetet:

1. QEVERISJA E MIRË DHE ANTIKORRUPSIONI

Qëllimi: Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset demokratike.

Prioritete:

- Trajnime dhe fushata për edukim ligjor dhe angazhim qytetar.
- Projekte për rritjen e integritetit dhe luftës ndaj korrupsionit në nivel lokal dhe qëndror.

2. PËRFSHIRJE SOCIALE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE FUQIZIMI I GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA

Qëllimi: Promovimi i barazisë, mbrojtjes sociale dhe përfshirjes së grupeve të pambrojtura.

Prioritete:

- Projekte për gra, minoritete dhe persona me aftësi të kufizuara.
- Aktivitet sportive dhe kulturore për përfshirje sociale.
- Fushata për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

3. ZHVILLIMI EKONOMIK, PUNESIMI DHE INOVACIONI

Qëllimi: Fuqizimi ekonomik i komuniteteve dhe rritja e punësimit nëpërmjet inovacionit dhe arsimit.

Prioritete:

- Trajnime profesionale për gra dhe të rinj.
- Projekte zhvillimi turizmi dhe agrobiznesi.
- Kurse edukimi digjital për grupet e marginalizuara në zonat më pak të zhvilluara.

4. MBROJTJA E MJEDISIT DHE TRANZICIONI I GJELBËR

Qëllimi Rritja e angazhimit komunitar për ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Prioritete:

- Fushata mbi ndryshimet klimatike dhe energjitë e rinovueshme.
- Projekte për ruajtjen e biodiversitetit dhe bujqësi e qëndrueshme.
- Edukim mjedisor dhe aktivizim qytetar.

5. KULTURA, ARSIMI, SHENDETI DHE TRASHËGIMIA

Qëllimi: Nxitja e edukimit, kultures dhe shendetit publik si mjete për zhvillim dhe kohezion social.

Prioritete:

- Promovimi i kultures dhe trashëgimise kulturore.
- Fushata ndergjegjesimi për shendetin mendor dhe publik.
- Aktivitet edukative dhe sportive për të rinj dhe femije.

2.4 Analiza e Përgjithshme e Thirrjes Nr. 18 për Projekt-Propozime (2025)

Në përputhje me misionin institucional dhe objektivat strategjikë, AMSHC ka shpallur gjatë vitit 2025 Thirrjen Nr. 18 për Projekt-Propozime, e cila është zhvilluar mbi bazën e parimeve të konkurrencës së hapur, barazisë së mundësive dhe transparencës administrative.

Procesi i aplikimit ka regjistruar interes të konsiderueshëm nga sektori i shoqërisë civile, duke reflektuar rritjen e kapaciteteve aplikuese dhe angazhimin e organizatave për të kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

TË DHËNA KRYESORE STATISTIKORE:


- Numri total i projekt-propozimeve të aplikuara: **160**
- Numri total i projekteve fituese: **75**
- Shuma totale e financuar nga AMSHC: **107,600,000 lekë**
- Shuma totale e kërkuar nga AMSHC përmes aplikimeve ka qenë **272,451,924 lekë**.

Projektet fituese janë përzgjedhur mbi bazën e kritereve të përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes, duke vlerësuar përputhshmërinë me prioritetet strategjike, realizueshmërinë teknike, kapacitetet institucionale të aplikantëve dhe impaktin social të pritshëm.


2.5 SHPËRNDARJA E PROJEKTEVE SIPAS FUSHAVE PRIORITARE

Tabela 2.1 - Shpërndarja e Projekteve dhe Fondeve sipas Fushave Prioritare (Thirrja Nr. 18 - 2025)

Fusha Prioritare	Nr. Projekteve	Përqindja (%)	Shuma (lekë)	Përqindja e Buxhetit (%)
Qeverisja e Mirë dhe Antikorrupsioni	37	49.3%	54,600,000	50.74%
Përfshirja Sociale dhe të Drejtat e Njeriut	6	8.0%	7,600,000	7.06%
Zhvillimi Ekonomik, Punësimi dhe Inovacioni	9	12.0%	11,300,000	10.50%
Mbrojtja e Mjedisit dhe Tranzicioni i Gjelbër	9	12.0%	10,500,000	9.80%
Kultura, Arsimi, Shëndeti dhe Trashëgimia Kulturore	8	10.7%	12,800,000	11.90%
Projektet Ndërsektorale (Shumë-prioritare)	6	8.0%	10,800,000	10.00%
Totali	75	100%	107,600,000	100%



Shpërndarja e projekteve fituese sipas fushave prioritiare



Shpërndarja e projekteve sipas fushave prioritiare pasqyron orientimin strategjik të AMSHC-së drejt ndërhyrjeve që adresojnë nevojat kryesore të zhvillimit institucional, social, ekonomik dhe mjedisor.

2.6 Analiza e Alokimit Financiar sipas Fushave Prioritare

Nga totali prej **107,600,000 lekësh**, prioriteti “Qeverisja e Mirë dhe Antikorrupsioni” përfaqëson peshën më të lartë financiare, duke reflektuar rëndësinë e projekteve që synojnë forcimin e transparencës, monitorimin e politikave publike dhe rritjen e llogaridhënies institucionale.

Fushat e zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe sektorëve socialë përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm të portofolit të financimeve, duke siguruar një qasje të balancuar midis zhvillimit ekonomik, kohezionit social dhe qëndrueshmërisë mjedisore.

Mesatarja e financimit për projekt në nivel thirrjeje rezulton rreth **1.43 milion lekë për projekt**, duke reflektuar orientimin e AMSHC-së drejt projekteve me impakt të strukturuar dhe të qëndrueshëm.

Shpërndarja tematike e projekteve të financuara në kuadër të Thirrjes Nr.18 pasqyron orientimin strategjik të AMSHC-së drejt mbështetjes së ndërhyrjeve që adresojnë nevojat prioritiare të shoqërisë shqiptare. Projektet janë fokusuar në fusha si qeverisja e mirë dhe antikorrupsioni, përfshirja sociale dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, zhvillimi ekonomik dhe punësimi, si dhe mbrojtja e mjedisit dhe tranzicioni i gjelbër.

Ky orientim ka mundësuar një shpërndarje të balancuar të fondeve dhe ka kontribuar në rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve të mbështetura.

Në përfundim të kësaj analize tematike, të dhënat e paraqitura në Tabelën 2.1 dhe Grafikët 2.1–2.3 konfirmojnë përputhshmërinë e prioritetëve të financimit me objektivat strategjike të AMSHC-së dhe politikat kombëtare të zhvillimit.

Përveç shpërndarjes numerike të projekteve, një element thelbësor i vlerësimit të impaktit të Thirrjes Nr.18 (2025) është analiza e alokimit financiar sipas fushave prioritiare.

Nga totali prej 107,600,000 lekësh të alokuara nga AMSHC, prioriteti “Qeverisja e Mirë dhe Antikorrupsioni” ka përfituar shumën më të lartë financiare, përkatësisht 54,600,000 lekë, që përfaqësojnë rreth 50.74% të buxhetit total të thirrjes.

Fusha e “Përfshirjes Sociale, të Drejtave të Njeriut dhe Fuqizimit të Grupeve të Margjinalizuara”

është mbështetur me 7,600,000 lekë ose 7.06% të buxhetit. Në prioritetin “Zhvillimi Ekonomik, Punësimi dhe Inovacioni” janë alokuar 11,300,000 lekë ose 10.50% e totalit. Fusha e “Mbrotjes së Mjedisit dhe Tranzicionit të Gjellbër” është financuar me 10,500,000 lekë ose 9.80%.

Ndërkohë, projektet në fushën “Kultura, Arsimi, Shëndeti dhe Trashëgimia Kulturore” janë mbështetur me 12,800,000 lekë ose 11.90% të buxhetit. Projektet që adresojnë më shumë se një fushë prioritare kanë përfituar 10,800,000 lekë ose 10.00% të totalit.

Analiza krahasuese e shpërndarjes numerike të projekteve dhe alokimit financiar tregon një përputhje të qartë ndërmjet peshës tematike dhe nivelit të financimit, duke reflektuar një orientim të qëndrueshëm të politikave mbështetëse të AMSHC-së drejt prioritetëve strategjike.

Nga 75 projekte fituese, me një buxhet total prej 107,600,000 lekësh, vërehet një strukturë e balancuar ndërmjet shpërndarjes numerike dhe alokimit financiar, duke garantuar eficiencë në përdorimin e fondeve publike dhe fokusim në prioritetet kombëtare të zhvillimit.

Për Projekt-propozimet fitues.

Projektpropozime sipas fushës së Prioriteteve	Thirrja Nr.18	
	Nr Projekteve	vlerë 000/lekë
Prioriteti 1	37	54600000
Prioriteti 2	6	7,600,000
Prioriteti 3	9	11,300,000
Prioriteti 4	7	10,500,000
Prioriteti 5	8	12,800,000
Prioriteti 6		
Prioriteti 7		
Me shume se nje fushe prioritare Total	8	10,800,000
Në 2 Prioritete	5	6,500,000
Në 3 Prioritete	2	2,600,000
Në 4 Prioritete	1	1,700,000
Në 5 Prioritete		
Shuma:	75	107,600,000

Prioriteti 1 – Qeverisja e Mirë dhe Antikorrupsioni

Kjo fushë përfaqëson prioritetin kryesor të financimit për vitin 2025. Me 37 projekte të financuara, që përbëjnë gati gjysmën e projekteve fituese, dhe me një buxhet prej 54,600,000 lekësh ose 50.74% të totalit, ky prioritet reflekton angazhimin institucional të AMSHC-së për forcimin e transparencës, monitorimit të politikave publike, rritjen e llogaridhënies institucionale dhe fuqizimin e rolit mbikëqyrës të shoqërisë civile.

Mesatarja e financimit për projekt në këtë fushë është rreth 1.48 milion lekë, çka tregon një fokus jo

vetëm sasior, por edhe cilësor, në ndërhyrje me impakt të strukturuar dhe afatgjatë.

Prioriteti 2 – Përfshirja Sociale, të Drejtat e Njeriut dhe Fuqizimi i Grupeve të Margjinalizuara

Në këtë fushë janë financuar 6 projekte, me një shumë totale prej 7,600,000 lekësh ose 7.06% të buxhetit total. Edhe pse përfaqëson një përqindje më të ulët krahasuar me prioritetet e tjera, ky sektor mbetet strategjik për politikat sociale dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël.

Mesatarja e financimit për projekt është rreth 1.26 milion lekë, duke reflektuar një qasje të orientuar drejt projekteve me ndërhyrje të drejtpërdrejta komunitare dhe shërbime sociale të specializuara.

Prioriteti 3 – Zhvillimi Ekonomik, Punësimi dhe Inovacioni

Në këtë prioritet janë mbështetur 9 projekte, me një financim total prej 11,300,000 lekësh ose 10.50% të buxhetit. Ky nivel financimi tregon vëmendjen e AMSHC-së ndaj projekteve që nxisin sipërmarrjen sociale, punësimin lokal dhe inovacionin ekonomik.

Mesatarja për projekt është rreth 1.25 milion lekë, duke siguruar mbështetje për iniciativa me potencial zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm.

Prioriteti 4 – Mbrojtja e Mjedisit dhe Tranzicioni i Gjelbër

Në fushën e mjedisit janë financuar 9 projekte, me një shumë prej 10,500,000 lekësh ose 9.80% të totalit. Ky rezultat pasqyron rritjen e ndërgjegjësimit institucional për çështjet e ndryshimeve klimatike, menaxhimit të mbetjeve, ruajtjes së biodiversitetit dhe edukimit mjedisor.

Mesatarja e financimit për projekt në këtë prioritet është rreth 1.16 milion lekë, duke mbështetur ndërhyrje konkrete lokale me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitete.

Prioriteti 5 – Kultura, Arsimi, Shëndeti dhe Trashëgimia Kulturore

Në këtë fushë janë financuar 8 projekte, me një vlerë totale prej 12,800,000 lekësh ose 11.90% të buxhetit. Ky nivel financimi reflekton rëndësinë e projekteve që kontribuojnë në ruajtjen e identitetit kulturor, përmirësimin e aksesit në arsim dhe promovimin e shëndetit publik.

Mesatarja e financimit për projekt arrin rreth 1.6 milion lekë, duke e bërë këtë prioritet ndër më të mbështeturit për nga niveli financiar për projekt individual.

Projektet Shumë-Prioritare (Ndërsektoriale)

Një element i rëndësishëm i Thirrjes Nr. 18 është mbështetja e projekteve ndërsektoriale, të cilat adresojnë më shumë se një fushë prioritare. Në këtë kategori janë financuar projekte me një vlerë totale prej 10,800,000 lekësh, ose 10% të buxhetit total.


Këto projekte reflektojnë një qasje moderne të politikave të financimit, duke integruar dimensionin social, ekonomik dhe mjedisor në ndërhyrje të kombinuara me impakt të zgjeruar.

Vlerësim Përmbledhës

Në tërësi, analiza tregon se ekziston një përputhje e qartë midis prioriteteve strategjike dhe alokimit financiar, buxheti është orientuar drejt fushave me ndikim të drejtpërdrejtë institucional dhe shoqëror, shpërndarja tematike garanton balancë ndërmjet qeverisjes, zhvillimit social dhe qëndrueshmërisë mjedisore.

Kjo strukturë financimi forcon rolin e AMSHC-së si instrument kyç në zbatimin e politikave publike dhe në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile në nivelme poshtë tabela dhe grafiku:

Projektpropozime sipas fushës së Prioriteteve	Thirrja Nr.16		Thirrja Nr.17	
	Nr Projekteve	vlerë 000/lekë	Nr Projekteve	vlerë 000/lekë
Prioriteti 1	21	30,400,000	3	4,000,000
Prioriteti 2	14	24,200,000	33	42,300,000
Prioriteti 3	19	27,000,000	14	17,200,000
Prioriteti 4	7	10,400,000	12	16,900,000
Prioriteti 5			5	6,800,000
Prioriteti 6			1	1,800,000.00
Prioriteti 7				
Me shume se nje fushe prioritare Total	3	3,500,000	5	7,500,000
Në 2 Prioritete	1	1,600,000	4	6,000,000
Në 3 Prioritete	2	1,900,000	1	1,500,000
Në 4 Prioritete				
Në 5 Prioritete				
Shuma:	64	95,500,000	73	96,500,000



Krahasimi ndërvite tregon një trend rritës të fondeve të alokuara për shoqërinë civile, duke reflektuar përmirësimin e kapaciteteve buxhetore dhe prioritarizimin e politikave mbështetëse për zhvillimin social dhe ekonomik.


Në Thirrjen 18 për Projekt Propozime kanë aplikuar rreth **160 OJF- aplikante**; me një shumë totale të kërkuar nga AMSHC-ja për totalin e projekteve prej: **272,451,924 lek**

Shpërndarja e Projekt Propozimeve sipas fushave prioritare për OJF-të Aplikante Thirrjes nr. 18 (13 Maj 2025 - 13 Qershor 2025)

Nr.	Fushat Prioritare	Nr. Projekteve për Prioritet	Shuma e Kërkuar nga AMSHC-ja për secilin prioritet	Pesha Specifike në %
1	1. QEVERISJA E MIRË DHE ANTIKORRUPSIONI	79	132,242,240	48.54
2	2. PËRFSHIRJE SOCIALE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE FUQIZIMI I GRUPEVE TE MARGJINALIZUARA	14	23,917,388	8.78
3	3.ZHVILLIMI EKONOMIK, PUNESIMI DHE INOVACIONI	16	28,926,310	10.62
4	4.MBROJTJA E MJEDISIT DHE TRANZICIONI I GJELBËR	11	17,212,867	6.3
5	5.KULTURA, ARSIMI, SHENDETI DHE TRASHËGIMIA	17	29,644,790	10.88
6	Me shumë se një fushë prioritare	24	40,508,329	14.9
Shuma në Total e kërkuar nga AMSHC-ja		160	272,451,924	100

Tabela 2.2 - Shpërndarja e Projekteve sipas Shtrirjes Gjeografike:

Nr	Qarku	Nr. Projekteve	% ndaj Totalit
1	Berat	5	6.70%
2	Dibër	4	5.30%
3	Durrës	8	10.70%
4	Elbasan	13	17.30%
5	Fier	8	10.70%
6	Gjirokastrë	2	2.70%
7	Korçë	7	9.30%
8	Kukës	5	6.70%
9	Lezhë	4	5.30%
10	Shkodër	11	14.70%
11	Tiranë	32	42.70%
12	Vlorë	19	25.30%
13	Projekte Kombëtare	3	4.00%
TOTAL		75	100%

Grafiku 2.4: Shpërndarja territoriale e projekteve fituese sipas Qarqeve Administrative - Thirrja Nr.18 (2025)

Shpërndarja territoriale e projekteve të financuara paraqitet në Tabelën e mësipërme 2.2, e cila pasqyron shpërndarjen e projekteve sipas qarqeve administrative dhe kategorisë së projekteve kombëtare. Gjithashtu kjo shpërndarje paraqitet gjithashtu në Grafikun e mësipërm, i cili ilustron peshën në të shpërndarjes së të projekteve sipas territorit.

Në kuadër të politikës së balancimit territorial, AMSHC-ja ka orientuar financimin e projekteve drejt një mbulimi sa më gjithëpërfshirës në nivel kombëtar.

Nga totali prej 75 projekteve të financuara, 72 projekte janë zbatuar në nivel qarku dhe 3 projekte kanë shtrirje kombëtare (multi-qark).

Shpërndarja gjeografike pasqyron përpjekjet institucionale për të garantuar akses të barabartë në financim publik dhe për të rritur impaktin social në komunitetet lokale.

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 2.2 dhe Grafikun 2.4 shërbejnë si bazë për analizën interpretuese të shpërndarjes territoriale dhe për identifikimin e zonave prioritare për ndërhyrje në thirrjet e ardhshme.

Të dhënat tregojnë se përqendrimi më i lartë i projekteve vërehet në qarqet me kapacitete më të konsoliduara organizative dhe densitet më të lartë të shoqërisë civile aktive, veçanërisht në Qarqet Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe Shkodër etj

Në nivel bashkie, evidentohet një përqendrim më i lartë i projekteve në qendrat urbane, ndërkohë që bashkitë me popullsi më të vogël dhe zona periferike paraqesin nevojë për ndërhyrje të mëtejshme në drejtim të forcimit të kapaciteteve lokale.

Projektet me shtrirje kombëtare përbëjnë një komponent të rëndësishëm të financimeve, pasi adresojnë problematika me ndikim të gjerë në nivel vendi dhe kontribuojnë në forcimin e politikave publike sektoriale.

AMSHC-ja do të vijojë orientimin e politikave mbështetëse drejt balancimit territorial, rritjes së aksesit në financim për organizatat lokale dhe përmirësimit të cilësisë së ndërhyrjeve sociale, me qëllim rritjen e impaktit të fondeve publike dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në zhvillimin e vendit.

KAPITULLI III

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Referuar nevojave dhe synimit për përafrimin e legjislacionit por jo vetëm, edhe strukturave shtetërore për funksionim edhe më të saktë të shoqërisë civile, Qeveria Shqiptare ndër morri iniciativën për themelimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Misioni themelor i këtij Këshilli do të jetë garantimi i bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile në dobi dhe në funksion të zgjerimit të demokracisë.

Në vazhden e kësaj nisme, Qeveria Shqiptare, në fundvitin e 2015-ës, miratoi Ligjin Nr. 119/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

Veprimtaria e KKSHC-së Janar - Dhjetor 2025



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë në rolin e Sekretariatit Teknik për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile, për vitin 2025 ka realizuar 1 mbledhje të Këshillit Kombëtar, përkatësisht në datën:

Mbledhja e Këshillit Kombëtar - 1 Prill 2025

Në mbledhjen e Nënt vitin 2025 shkak për mosrealizimin e mbledhjeve të tjera ishte zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025, dhe ndryshimi i Qeverisë në Shtator 2025. Gjatë këtij viti janë realizuar dhe zgjedhjet për 5 anëtarët e rinj të KKShC-së. Procedura për kandidaturat e reja për vakancat e krijuara në KKShC u hap në Maj- Qershor 2025. Për shkak të numrit të ulët të kandidatëve komisioni i zgjedhjeve mori vendimin për shtyrjen e kësaj procedure. Në Shtator-Tetor 2025 u rihap sërish Thirrja për kandidatura të reja për vakancat e krijuara në KKShC. Për anëtarë të KKShC-së erdhen 13 kandidatura ku 12 prej tyre kaluan fazën e plotësimit të dokumentacionit të kërkuar. Pas votimit online, dolën dhe kandidatët më të votuar që janë përkatësisht:

Për fushën e veprimit A: Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE

- a) Mirjam Reçi
- b) Blerta Tuci
- c) Irena Topalli

Për fushën e veprimit B: **Zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor**

- a) Arta Nikolli
- b) Vilson Shehu

2. Çështjet e diskutuara në mbledhjen e KKShC-së për vitin 2025 janë:

- a) Përditësime mbi çështjet e ngritura nga mbledhjet paraprake;
- b) Prezantim i problematikave të hasura nga shoqëria civile në kuadër të tkurrjes së burimeve financiare nga donatorët ndërkombëtarë;
- c) Procesi integrimi të Shqipërisë në BE, roli i organizatave të shoqërisë civile në këtë proces;
- d) Efikasiteti i Ligjit për Sponsorizimet;
- e) Prezantime mbi mbështetjen financiare për shoqëri civile nga institucione shtetërore shqiptare;

Ju lutemi referojuni link-ut dhe dokumentave të mëposhtme për përpunimin sasior dhe cilësor të informacionit që ju nevojitet:

<https://kkshc.gov.al/procesverbal-mbledhje-kkshc-01-04-2025/>

KAPITULLI IV

SEKTORI I FINANCËS DHE KONTROLLIT TË BRENDSHËM

AMSHC është një institucion qendror buxhetor, i krijuar për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe për të krijuar kushte të favorshme për nisma qytetare në interes të publikut.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, paraqet Raportin Vjetor mbi Zbatimin dhe Monitorimin e Buxhetit për Vitin 2025, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 115/2024 “Për Buxhetin e Vitit 2025” dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave.

Buxheti total i miratuar për AMSHC-në për vitin 2025 ishte **135,775,000 lekë**, me një nivel realizimi prej **94%**, duke reflektuar një menaxhim financiar të qëndrueshëm, eficient dhe të orientuar drejt rezultateve.

Gjatë vitit raportues, fokusi kryesor i institucionit ka qenë financimi i projekteve të shoqërisë civile, monitorimi i tyre në terren dhe rritja e kapaciteteve të organizatave jofitimprurëse në përputhje me prioritetet kombëtare dhe evropiane.

Ky raport i ecursisë financiare synon të informojë publikun, institucionet qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë mbi mënyrën e përdorimit të fondeve publike, nivelin e realizimit të treguesve buxhetorë dhe performancën institucionale në funksion të misionit të AMSHC-së.

Fokusi kryesor i veprimtarisë edhe për Vitin 2025 ka qenë:

- financimi i projekteve të shoqërisë civile;
- monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të financuara;
- mbështetja e përfshirjes qytetare, barazisë gjinore dhe qeverisjes së mirë;
- kontributi në proceset integruuese evropiane.

Baza ligjore dhe metodologjia e raportimit

Raporti është përgatitur në përputhje me:

- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”;
- Ligjin nr. 115/2024 “Për Buxhetin e Vitit 2025”;
- Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018;
- Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025;
- Udhëzimin nr. 14, datë 30.05.2023 për monitorimin buxhetor;
- Formatet standarde të raportimit të përcaktuara në Shtojcën 3 të udhëzimit përkatës.

Metodologjia e raportimit bazohet në:

- krahasimin e treguesve të planifikuar me realizimin faktik;
- analizën e shpenzimeve sipas zërave ekonomikë;
- lidhjen e fondeve me produktet dhe objektivat e arritura.

Programi Kryesor Buxhetor

Programi buxhetor “Mbështetje për Shoqërinë Civile” synon:

- fuqizimin e OJF-ve;
- rritjen e transparencës dhe llogaridhënies;
- përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël;
- mbështetjen e reformave dhe politikave publike.

Produktet kryesore të programit janë:

1. Financimi i projekteve të OJF-ve;
2. Monitorimi dhe inspektimi i projekteve;
3. Asistenca teknike dhe ndërtimi i kapaciteteve.

Buxhetimi gjinor

AMSHC ka integruar buxhetimin gjinor në planifikim dhe monitorim:

- 50% e posteve drejtuese mbahen nga gra;
- projekte të dedikuara për fuqizimin e grave dhe vajzave;
- përputhshmëri me standardet e BE-së për barazi gjinore.

AMSHC vlerëson se viti 2025 ka qenë një vit me performancë të qëndrueshme financiare dhe institucionale.

Gjithashtu rekomandohet:

- rritje e fondeve për grante;
- zgjerim i monitorimeve në terren;
- forcim i bashkëpunimit me partnerët evropianë.

Monitorim/ Vlerësimi i performancës së treqesve Buxhetore për Vitin 2025

Programi kryesor buxhetor I AMSHC –së si Institucion është Mbështetje për Shoqërinë Civile, me qëllim krijimin e kushteve për rritje të qëndrueshme të shoqërisë civile në vend përmes një shoqërie civile më vibrante dhe pjesëmarrëse në vendimarrje dhe monitorim politikash publike.

Politikat ekzistuese të programit të AMSHC-së, ose produktet kryesore që AMSHC prodhon në formën e shërbimeve të cilat janë tre si më poshtë listuar:

- 1- Realizimi i thirrjeve për Projekt propozime dhe financimi I projekteve të OJF- ve.
 - 2-Realizim në terren i monitorimeve/inspektimeve të projekteve të financuara nga AMSHC.
 - 3-Mbështetje/asistence teknike dhe informuese e OJF-ve nëpërmjet takimeve informuese/konsultative si dhe trajnimeve për rritje kapaciteti i OJF-ve.
- Institucioni ka arritur objektivin e tij, mbështetjen financiare dhe monitorimin/vlerësimin e projekteve të OJF-ve sipas programeve të miratuara nga Bordi Mbikqyrës i AMSHC-së nëpërmjet

menaxhimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomik të burimeve financiare dhe njerëzore të Institucionit.

Monitorimi në këtë rast është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Pra, monitorimi buxhetor është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Me anë të këtij raporti monitorimi të Buxhetit të AMSHC - së për Vitin 2025, përcjellim informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2025 përse i përket Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Në përdorimin e fondeve buxhetore, AMSHC – ja është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor.

Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e AMSHC-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara nga Agjencia për Mbështetje të Shoqërisë Civile për vitin 2025.

Plani fillestar i Buxhetit Viti 2025/ Informacion buxhetor i agreguar

Në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Mbështetur Nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025, në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit plotësues Nr.2, datë 24.01.2025 ”Për zbatimin e buxhetit të Vitit 2025”.

Fondet buxhetore të akorduara për vitin 2025 janë në vlerën 130,675,000 lekë për shpenzime korrente dhe kapitale :

Tab në lekë

EMËRTIMI	VITI 2025
Shp. Paga & Sig. Shoq.	26,280,000
Shp. të tjera korrente	108,395,000
Shp.kapitale të brendshme	1,000,000
Totali	135,675,000

Ndërkohë, në **fazën strategjike dhe teknike të përgatitjes së PBA-së** 2026 -2028 dorëzuar në Maj 2025, janë përgatitur kërkesat buxhetore të cilat do t'i shërbëjnë arritjes së objektivave të Institucionit.

➤ Politikë ekzistuese por kërkesë për shtim fondi :

Emërtimi: Mbështetje me fonde e më shumë projekteve të shoqërisë Civile

Kosto totale : 30,000,000 lekë

Argumentimi i nevojës për këtë politikë :

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile tashmë funksionon prej disa vitesh dhe ka mbështetur

financiarisht shumë projekte të Shoqërisë Civile për një shërbim më të mirë ndaj qytetarit, për nisma civile në emër të transparencës apo luftës kundër korrupsionit duke ju përgjigjur kërkesës së shoqërisë gjithashtu edhe programeve strategjike të qeverisë.

Por, eksperiencia e deritanishme tregon se ka një hapësirë të madhe bosh mes projekteve që aplikojnë për financim pranë AMSHC-së (rreth 250 - 300 projekte) dhe atyre projekteve më cilësore të cilat AMSHC arrin të mbështesë me fonde nisur nga fondet ekzistuese që i jepen nga buxheti i shtetit (rreth 65-70 projekte në vit) duke lënë kështu rreth 80% të projekteve që aplikojnë për fonde dhe financim pranë AMSHC –së pa mbështetje financiare!

Vlerësuar edhe në terma të një impakti të qenësishëm dhe konkret në shoqëri, AMSHC ka nevojë për më shumë fonde në llogarinë e granteve që nga një anë përbën edhe produktin kryesor të punës dhe nga ana tjetër kjo përkthehet në më shumë projekte në ndihmë dhe për grupet më të marginalizuara dhe në nevojë të shoqërisë, për monitorimin e politikave publike, për sensibilizimin e publikut në kuadër të integritetit në BE, për luftën kundër korrupsionit në çdo nivel të shfaqjes së tij pra në dobi dhe interes të qytetarëve.

Analizë në lidhje me buxhetimin gjinor dhe adresimin e ndryshimeve klimatike

Duke vlerësuar konstatimet dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave përsa i përket Përgatitjes së PBA –së 2026-2028 , Ekipi i Menaxhimit të Programit gjatë vitit 2025, ka bërë një punë të përgjegjshme në drejtim të respektimit të përcaktimeve të udhëzimit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm përshtatur specifikisht për natyrën e detyrave dhe përgjegjësi që AMSHC mbulon.

Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

Duke vlerësuar konstatimet dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave përsa i përket Përgatitjes së PBA –së 2026 – 2028, Ekipi i Menaxhimit të Programit gjatë vitit 2025, ka bërë një punë të përgjegjshme në drejtim të respektimit të përcaktimeve të udhëzimit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm përshtatur specifikisht për natyrën e detyrave dhe përgjegjësi që AMSHC mbulon në bazë të Ligjit mbi të cilin është krijuar dhe funksionon tashmë prej nga Viti 2009.

- Së pari, në kuadër të pikës 3 të Udhëzimit nr.10, dt.28.02.2017 “*Përfshirja e shoqërisë Civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm*”, ju vemë në dijeni se pjesë e planeve të punës në baza vjetore për AMSHC- në, është gjithmonë realizimi i takimeve konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në Shqipëri me qëllim njohjen me problematikat e hasura, me sugjerimet e tyre lidhur me organizimin e punës në Institucion, sugjerimet e tyre përsa i përket detajimit të zërave buxhetore si dhe përsa i përket aktiviteteve që janë të rëndësishme për t’u organizuar me qëllim përcjelljen e “feedback” të qartë të OJF-ve në punën tonë të përditshme si Institucion që mbështet fuqizimin e një Shoqërie Civile të qenësishme në vend.

Sipas sugjerimeve të Ministrisë së Financave, është shtuar tek “Objektivi i politikës së programit “Mbështetje financiare dhe monitorim për më shumë projekte të OJF- ve” sipas programeve të përcaktuara nga Bordi Mbikqyrës i AMSHC -së në vit, është shtuar tek “Treguesi e Performancës për Objektivin”, objektivi “***Përqindja e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese***”, objektivi i cili raportohet 50% për periudhën e raportimit pra për katër mujorin e tretë të Vitit 2025.

- Në kuadër të udhëzimit për adresimin e pabarazive gjinore, janë përfshirë në Thirrjen nr.18 për ProjektPropozime **prioritete të cilat kanë për qëllim të targetojnë pabarazinë gjinore. konkretisht, në Shpalljen e Thirrjes nr.18 është përcaktuar prioriteti si më poshtë :**

➤ **PËRFSHIRJE SOCIALE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE FUQIZIMI I GRUPEVE TE MARGJINALIZUARA**

Qëllimi: Promovimi i barazisë, mbrojtjes sociale dhe përfshirjes së grupeve te pambrojtura.

Prioritete:

1. Projekte për gra, minoritete dhe persona me aftësi të kufizuara.
2. Aktivitet sportive dhe kulturore për përfshirje sociale.
3. Fushata për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

Për këtë prioritet aktualisht janë shpallur 7 projekte fituese dhe janë lidhur kontratat për projekte me vlerë financimi totale 9,300,000 lekë.

Gjithashtu, në kuadër të udhëzimit për adresimin dhe integrimin e ndryshimeve klimatike në procesin e buxhetimit (shtuar me Udhëzimin nr.12, datë 18.10.2024), duhet theksuar se në Thirrjen aktuale për Projektpropozime (Thirrja Nr.18), është përcaktuar prioriteti për adresimin e çështjeve klimatike si më poshtë vijon:

➤ **MBROJTJA E MJEDISIT DHE TRANZICIONI I GJELBËR**

Qëllimi: Rritja e angazhimit komunitar për ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Prioritete:

1. Fushata mbi ndryshimet klimatike dhe energjitë e rinovueshme.
2. Projekte për ruajtjen e biodiversitetit dhe bujqësi e qëndrueshme.
3. Edukim mjedisor dhe aktivizim qytetar.

Për këtë prioritet aktualisht janë shpallur fituese dhe janë lidhur kontratat për 8 projekte me vlerë financimi totale 11,400,000 lekë.

Performanca Financiare e programit buxhetor/ Analiza e realizimit të treqesve buxhetore 2025**Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile**

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Vendim nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ndryshuar me Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, Mbështetur në Ligjin Nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025, në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të VKM –së Nr.19, dt. 9.01.2025 “Për Përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të përkohshme për Vitin 2025 në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, përgjatë Vitit 2025, është realizuar respektivisht;

- **22,158,025 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi prej 99 % për periudhën e raportimit vjetor.
- **3,549,084 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore shendetsore, realizimi 86 % për periudhën e raportimit vjetor.

Fondi për shpenzime të tjera korrente (zeri 602), për vitin 2025, është planifikuar fillimisht me Ligjin e Buxhetit të Vitit 2025 në vlerën **5,395,000 leke**.

Në këtë zë buxhetor është mbështetur edhe veprimtaria dhe aktivitetet e KKSHC- së nisur edhe nga detyrat që AMSHC –ja ka përmbushur përgjatë Vitit 2025 si Sekretariat i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile duke mbuluar aktivitetet e KKSHC –së si dhe për të siguruar facilitetet logjistike për organizimin e mbledhjeve të KKSHC –së.

Ofrimi i asistencës ligjore në finalizimin e Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile ku AMShC ndërmori një rol të rëndësishëm në hartimin dhe mirëpërcaktimin e planit të punës dhe më gjerë. Për këtë funksion, AMShC gjithashtu ndërmori një sërë masash me qëllim realizimin sa më të saktë të tij duke përthithur produktin final (miratimin dhe zbatimin e Udhërrëfyesit).

Roli aktiv i AMShC- së në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit është një tjetër arritje e Institucionit duke ndikuar në plotësimin e masave dhe indikatorëve sa i përket Qasjes Ndërgjegjësuere. Për këtë qëllim, AMShC ka tashmë programin e saj Institucional kundër Korrupsionit, një buxhet të dedikuar për projektet anti- korrupsion. Në zërin buxhetor të AMSHC – së , disa shpenzime operative dhe të stafit i janë dedikuar edhe kësaj strategjie.

Edhe për këtë zë, përgjatë kësaj periudhe raportimi është realizuar vlera në total prej **2,974,060 Lekë**.

Një arsye për këtë rezultat fakt të shpenzimeve të zërit shpenzime operative dhe mirëmbajtje e

shërbime /llogaria 602 janë edhe procedurat e prokurimeve për blerje të vogël të vogël online të cilat janë parashikuar për t'u zhvilluar në katër mujorin e fundit të vitit 2025 duke synuar për çmimin më të ulët për blerjet dhe shërbimet në kuadër të logjistikës së përgjithshme për ecurinë normale të punës në Institucion.

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC-ja është mbështetur në parimin e një shpërndarje sa më racionale të kërkesave për ecurinë optimale të veprimtarisë së Institucionit si dhe ka zbatuar “Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për Vitin 2025 ” për blerje dhe shërbime të cilat kryesisht lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevoja të AMSHC-së, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, lyerje dhe mirëmbajtje, pastrim etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitorë dhe të tretë etj.
- Kryerjen e monitorimeve në terren të projekteve që AMSHC ka financuar gjatë vitit 2025.
- Realizimin e study- tour në vende të rajonit për shkëmbimin e eksperiencave më të mira për zhvillimin dhe mbështetjen e shoqërisë civile.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zeri 604), për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **103,000,000 leke**.

Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC- së, duke qenë se Institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet e OJF- të përfituese. Përgjatë Vitit 2025 është zhvilluar praktika për shpalljen/vlerësimin/lidhjen e kontratave për Thirrjen për Projekt-Propozime Nr.18 si rezultat i së cilës janë shpalluar nëpërmjet procesit 75 projekte fituese të cilat janë në ndjekje në vijim.

Edhe për këtë zë, aktualisht **604 Kapitulli 1** për periudhën respektive është realizuar vlera prej **99,770,000 Lekë** ose **96% e planit vjetor**.

Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja Nr.16, dhe në gjysmën e dytë të Vitit fiskal 2025 janë disbursuar Projektet fituese të Thirrjes Nr.17 organizuar nga AMSHC-ja të cilat janë aktualisht në zhvillim dhe pritet të përfundojnë përgjatë vitit 2025. Gjithashtu është ndjekur Thirrja nr.18 për projekt-propozime e cila është Disbursuar nga Qershori- Gusht pjesa prej 70% e granteve sipas kontratës mes palëve.

(Llogaria 604 –Disbursimi i Granteve) Gjatë vitit 2025, disbursimet e granteve më së shumti janë përqendruar në muajt Qershor - Gusht 2025 pas shpalljes së OJF- ve fituese të Thirrjes nr.18 sipas përcaktimeve të kontratave lidhur mes OJF -ve dhe AMSHC- së.

Fondi për shpenzim investime (zeri 231) ,

1,000,000 Lekë (zeri 231) për Investime të Trupëzuara,

Gjatë katër mujorit të tretë të vitit 2025, ky zë buxhetor raportohet të jetë realizuar në vlerën 315,600 lekë pas përfundimit të procesit të prokurimit Blerje e Vogël me subjekt *”Blerje mobilie për nevojat e Institucionit”*. Realizimi për këtë zë është në vlerën 31 %.

4.1. Analiza e realizimit të treqesve buxhetore për Vitin 2025

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës i AMSHC- së, ka organizuar **Thirrjen Nr. 18 për Projekt-Propozime** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurese për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese. Më tej puna konkrete e AMSHC- së si Institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri në fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi i ecursë së realizimit të Aktiviteteve konform projekt-propozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi i ecursë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC- ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacioni fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Veprimtaria kryesore e AMSHC- së për Vitin 2025 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjes për Projekt-Propozim si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimit të projekteve të zbatuara në kuadër të Thirrjes për projekt-propozim.

Përsa i përket realizimit të **“Output Monitoring Data”** nga targeti aktual i përditësuar përsa i takon **“Numrit të projekteve të financuara”**, nga totali prej 80 projektsh janë financuar 73 projekte nëpërmjet Thirrjes nr.17, projekte të cilat janë disbursuar 50% me lidhjen e kontratës dhe do ndiqen në vijueshmëri deri në përfundimin e tyre.

Përsa i përket realizimit të **“Output Monitoring Data”** nga targeti aktual i përditësuar përsa i takon **“Numrit të projekteve të financuara”**, nga totali prej 80 projektsh janë financuar 75 projekte nëpërmjet Thirrjes nr.18, projekte të cilat janë disbursuar 70% me lidhjen e kontratës dhe do ndiqen në vijueshmëri deri në përfundimin e tyre.

Ndërsa përsa i përket realizimit faktitk të **“Numrit të monitorimeve të kryera në terren”**, nga targeti i përditësuar prej 74 monitorimesh janë realizuar për katër mujorin e dytë të vitit 2025 janë realizuar 5 monitorime në terren për Thirrjen nr.17 përgjatë Vitit 2025 dhe në mënyrë progresive janë bërë 31 monitorime në terren.

Ndërkohë do të zhvillohen dhe janë në zbatim monitorimet në terren për projektet e Thirrjes nr.18 të cilat janë në proces realizimi aktualisht!

Ndërkohë, përgjatë Vitit 2025 kanë vazhduar monitorimet në terren të projekteve të cilat financohen nga AMSHC –ja, gjithashtu raportohen edhe udhëtimet e punës / konsultimet publike të realizuara përgjatë Vitit 2025 të cilat kanë si qëllim Rritjen e pjesëmarrjes së OShC-ve në menaxhimin e

instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit; Koordinimin e financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile; etj

Llogaria 602 e shpenzimeve operative të stafit dhe shërbimeve është fond i cili është përdorur kryesisht për mbulimin e shpenzimeve me karakter “*monitorim/vlerësim në terren të projekteve financuar nga AMSHC*”, si dhe për mbulimin e eventeve me qëllim rritje kapacitetesh teknike të OJF -ve si pjesë e qëllimit afatgjatë të punës së AMSHC- së, si edhe për *arritjen e objektivave më imediate si Institucion në një moment kaq të rëndësishëm për vendin tonë në tërësi si edhe për procesin e Integrimit në BE, ku përfshirja e OSHC –ve është tejet e rëndësishme !*

5. Rishikimi i buxhetit për Vitin 2025 nëpërmjet Akteve Normative dhe shkresave për rialokime brenda programit.

Në këtë Fazë të raportimit të realizimit të buxhetit për Vitin 2025 , është e rëndësishme të reflektohet ndryshimi i ndodhur nëpërmjet aktit normativ të Dhjetor 2025.

Mbështetur në Aktin Normativ Nr.11, datë 19.12.2025. “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.115/2024 “Për Buxhetin e Vitit 2025” të ndryshuar, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr.2 datë 24.01.2025 “ Për zbatimin e buxhetit të Vitit 2025”, mme poshte shenuar gjendet plani i rishikuar i buxhetit për vitin 2025 sipas tabelës me poshte shenuar.*

Ne zbatim te Aktit Normativ Nr.11 dt.19.12.2025								
Viti 2025								Tab ne Leke
Ent.Qe verisje	Min Linjes	Kod Institucioni	Emer Institucion	Kapitulli	Programi	Llog.Ekonomike	Kod Thesari	Shuma
Pakesohet Dhjetor 2025								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	601000	3535	60.000
Shtohet Dhjetor 2025								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	600000	3535	60.000

Gjithahstu, mbështetur në Ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit*”, sipas përcaktimeve të Udhëzimit plotësues Nr.2, datë 24.01.2025 ”Për zbatimin e buxhetit të Vitit 2025” , pika 69 e Udhëzimit, eshte kerkuar miratimi ne në nivel njësie shpenzuese për llogarinë 606 për përdorim përgjatë Vitit 2025 sipas Fondit të veçantë alokuar Agjencisë për Mbështetje të Shoqërisë Civile i cili eshte miratuar ne vleren 100,000 leke..

Pas ndryshimeve të kërkuar Plani i buxhetit përfundimtar për AMSHC –në për vitin 2025 është si më poshtë :

Plani i Buxhetit përfundimtar për AMShC-në – Viti 2025 pas ndryshimeve të ndodhura përgjatë vitit 2025


Fondi i Pagave (zëri 600)	22.160,000	Lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore (zëri 601)	4,120,000	Lekë
Fondi për Shpenzime Operative (zëri 602)	5,395,000	Lekë
Fondi për transfertat ndaj të tretëve (zëri 604)	103,000,000	Lekë
Zëri shpërblime/ndihmë ekonomike	100,000	Lekë
Fondi për Investimet e Trupëzuara (zëri 231)	1,000,000	Lekë
TOTAL	135,775,000	Lekë

Mbi detajimin e buxhetit të këtij viti duhet theksuar detajimi në dy produkte të buxhetit akorduar AMSHC –së, të tilla si 98801AA si dhe 98801AB ku produktet të parashikuara në PBA e Vitit 2025 sipas formateve të reja kanë qenë dy të tilla si :

Projekte të financuara nga AMSHC –ja si dhe Monitorime/Inspektime në terren.

➤ **Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile**

Ecuria e realizimit buxhetor për Vitin 2025			
Struktura Buxhetore	Shpenzimet Progressive Fakt	Plani Vjetor sipas ndryshimeve të bera gjatë vitit	Realizimi ne Përqindje
600 - Llogaria e pagave	22,158,025	22,160,000	99 %
601 - Kontribute sig shoq shend	3,549,084	4,120,000	86 %
602 - Shpenzime të tjera Korrente	2,974,060	5,395,000	55 %
604/1 - Tranferta GRANTE	99,770,000	103,000,000	96 %
Transferta buxhetore familjare	30,000	100,000	30%
231 - Investimet të brendshme	315,600	1,000,000	31 %
Totali	128,796,770	135,775,000	94 %



Niveli i lartë i realizimit të granteve (96%) tregon fokusin e AMSHC-së në misionin kryesor, ndërsa realizimi më i ulët në shpenzimet operative dhe investime lidhet me:

- racionalizimin e shpenzimeve;
- planifikimin e procedurave të prokurimit në fund të vitit;
- orientimin drejt kursimit të fondeve publike

AMSHC është një Institucion qendror buxhetor i krijuar me Ligjin Nr. 10093 Date 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe VKM Nr. 769 Date 15.07.2009 “Per Miratimin e Statutit të AMSHC-se” (I ndryshuar), me Mision themelor **“Nxitjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shoqërisë Civile”**, si dhe **“Krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile”**, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për realizimin e Misionit, AMSHC-ja ofron **“asistencë financiare”** për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera si

trajnime/workshope/konferenca/takime rajonale që lehtësojnë përmbushjen e misionit të Institucionit.

Duke filluar nga **muaji Nëntor 2010 e deri në fund të vitit 2025** Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës i AMSHC- së, ka organizuar **Thirrjen nr. 18 për Projekt-Propozime** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurëse për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese. Më tej puna konkrete e AMSHC- së si Institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri në fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së realizimit të Aktiviteteve konform projektpropozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si

dhe Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC- ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacionin fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Sasia e granteve dhe Organizatave Jofitimprurëse të kontraktuara për t'u Financuar për secilën Thirrje të organizuar nga AMSHC paraqitet si vijon

Tabela (ne Leke):

Thirrje per ProjektPropozime	Numri i OJF-ve Perfituese	Vlere e Granteve financiare (ne Leke)
Thirrje Nr.1	52	125,918,000
Thirrje Nr.2	31	16,000,000
Thirrje Nr.3	69	131,960,000
Thirrje Nr.4	63	62,105,000
Thirrje Nr.5	47	55,200,000
Thirrje Nr.6	21	43,755,840
Thirrje Nr.7	41	73,500,000
Thirrje Nr.8	18	36,000,000
Thirrje Nr.9	41	85,200,000
Thirrje Nr.10	35	95,100,000
Thirrje Nr.11	45	107,700,000
Thirrja Nr.12	52	115,600,000
Thirrja Nr.13	46	41,230,000
Thirrja Nr.14	72	108,650,000
Thirrja Nr.15	62	95,500,000
Thirrja Nr.16	63	95,500,000
Thirrja Nr.17	73	96,500,000
Thirrja Nr.18	74	109,300,000
TOTAL	905	1,399,218,840

Puna kryesore e AMSHC- së për Vitin 2025 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjeve për Projekt Propozime si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimit të projekteve të zbatuara në kuadër të këtyre Thirrjeve.

Aktualisht, mund të themi se AMSHC në fund të vitit 2025, ka lidhur kontrata për realizimin e 905 projekteve të Shoqërisë Civile në një vlerë totale prej rreth 13 milion euro, duke e fokusuar punën në monitorimet në terren dhe me bazë dokumnetacioni të këtyre projekteve të cilat janë nisma civile dhe projekte dedikuar grupeve vulnerabël të shoqërisë.

Fushat prioritare të shpërndarjes së fondeve për Vitin 2025 për Thirrjen për Projekt-propozime paraqiten si më poshtë vijon:

FUSHAT MBI PËRPARËSITË/PRIORITETET TË PROJEKT-PROPOZIMEVE:

1. QEVERISJA E MIRË DHE ANTIKORRUPSIONI

Qëllimi: Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset demokratike.

Prioritete:

- Trajnime dhe fushata për edukim ligjor dhe angazhim qytetar.
- Projekte për rritjen e integritetit dhe luftës ndaj korrupsionit në nivel lokal dhe qendror.

2. PËRFSHIRJE SOCIALE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE FUQIZIMI I GRUPEVE TE MARGJINALIZUARA

Qëllimi: Promovimi i barazisë, mbrojtjes sociale dhe përfshirjes së grupeve te pambrojtura.

Prioritete:

- Projekte për gra, minoritete dhe persona me aftësi të kufizuara.
- Aktivitet sportive dhe kulturore për përfshirje sociale.
- Fushata për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

3. ZHVILLIMI EKONOMIK, PUNESIMI DHE INOVACIONI

Qëllimi: Fuqizimi ekonomik i komuniteteve dhe rritja e punësimit nëpërmjet inovacionit dhe arsimit.

Prioritete:

- Trajnime profesionale për gra dhe të rinj.
- Projekte zhvillimi turizmi dhe agrobiznesi.
- Kurse edukimi digjital për grupet e marginalizuara në zonat më pak të zhvilluara.

4. MBROJTJA E MJEDISIT DHE TRANZICIONI I GJELBËR

Qëllimi: Rritja e angazhimit komunitar për ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Prioritete:

- Fushata mbi ndryshimet klimatike dhe energjitë e rinovueshme.
- Projekte për ruajtjen e biodiversitetit dhe bujqësi e qëndrueshme.
- Edukim mjedisor dhe aktivizim qytetar.

5. KULTURA, ARSIMI, SHENDETI DHE TRASHËGIMIA

Qëllimi: Nxitja e edukimit, kultures dhe shendetit publik si mjete për zhvillim dhe kohezion social.

Prioritete:

- Promovimi i kultures dhe trashëgimise kulturore.
- Fushata ndergjegjesimi për shendetin mendor dhe publik.
- Aktivitet edukative dhe sportive për të rinj dhe femije.

KAPITULLI V

❖ Aktivitetet kryesore të AMSHC-së për vitin 2025

Shprehje interesi për ngritjen e Komiteteve të Përbashkëta Konsultative me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe me Komitetin e Rajoneve të Bashkimit Evropian

Tiranë, 23 janar 2025



Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 187, datë 18.09.2024 “Për ngritjen e Komiteteve të Përbashkëta Konsultative (KPK) me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (KESE) dhe me Komitetin e Rajoneve të Bashkimit Evropian”, drejton procesin e përzgjedhjes e të emërimit të anëtarëve shqiptarë të KPK me KESE, në bazë të propozimeve të partnerëve socialë dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile.

Për këtë qëllim, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, shpallën “Thirrje për shprehje interesi”, duke ftuar përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile për të qenë përfaqësues të palës shqiptare në Komitetin e Përbashkët Konsultativ (KPK) me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (KESE), për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Komiteti i Përbashkët Konsultativ me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian krijohet me detyrën për të ndihmuar Këshillin e Stabilizim-Asociimit, me synimin për të nxitur dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet partnerëve socialë dhe organizatave të tjera të

shoqërisë civile në Bashkimin Evropian dhe në Shqipëri. Një dialog dhe bashkëpunim i tillë do të përfshijë të gjitha aspektet përkatëse të marrëdhënieve ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, siç paraqiten në kontekstin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Dialogu dhe bashkëpunimi i tillë synon veçanërisht:

- a) përgatitjen e punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile shqiptare për veprimtari në kuadrin e anëtarësimit të ardhshëm në Bashkimin Evropian;
- b) përgatitjen e punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile shqiptare për pjesëmarrjen e tyre në punën e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian pas aderimit të Shqipërisë;
- c) shkëmbimin e informacionit për çështjet aktuale me interes të ndërsjellë, veçanërisht mbi rrethanat aktuale të procesit të aderimit, si dhe përgatitjen e punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile për atë proces;
- d) inkurajimin e shkëmbimeve të përvojës dhe dialogut të strukturuar ndërmjet punëdhënësve shqiptarë, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile dhe punëdhënësve, punëtorëve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile nga shtetet anëtare, duke përfshirë nëpërmjet rrjetëzimit në fusha specifike ku kontaktet dhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë mund të rezultojnë të jenë mënyra më efektive e zgjidhjes së problemeve të veçanta;
- e) Diskutimin e çdo çështjeje tjetër që lind në kontekstin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duke përfshirë në lidhje me procesin e aderimit të Shqipërisë.

Komiteti i Përbashkët Konsultativ me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian do të përbëhet nga gjashtë përfaqësues të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe gjashtë përfaqësues të partnerëve socialë të Shqipërisë dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile. Vëzhguesit gjithashtu mund të ftohen të marrin pjesë.

Komiteti i Përbashkët Konsultativ me Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian do të kryejnë detyrat e tyre në bazë të konsultimit nga Këshilli i Stabilizim-Asocimit ose, në lidhje me nxitjen e dialogut ndërmjet qarqeve ekonomike dhe sociale, me nismën e tij.

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Tiranë, 13 shkurt 2025



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në mbështetje të nenve 9, 10, 11 e vijues të Ligjit Nr.10 093/2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, organizoi mbledhjen e Bordit Mbikqyrës ditën e enjte, datë 13 Shkurt 2025.

Në mbledhje u trajtuan çështjet e mëposhtme:

1. Miratimi i Raportit Vjetor për vitin kalendarik 2024, për gatitur nga AMSHC për veprimtarinë e saj sipas përcaktimeve që legjislacioni në fuqi bën.
2. Diskutimi mbi politikat përcaktuese të përparësive, që do të mbliidhen nga propozimet e OJF-ve në Qarqet e Shqipërisë.
3. Miratimin e përmbajtjes të anketës të për gatitur nga AMSHC për mbledhjen në formë statistikore të të dhënave të OJF-ve për disa shtylla ku bazohet veprimtaria e tyre.

Takime informuese dhe konsultime publike me Organizata të Shoqërisë Civile në kuadër të Thirrjes Nr.18

25 shkurt - 4 prill 2025



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile , dhe krijimin

e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut si dhe në kuadër të Ligjit Nr. 146/ 2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”;

Procesi i konsultimit publik në kuadër të përcaktimit të prioriteteve mbi thirrjes e radhës në qytete e Shqipërisë si mëposhtë:

- Vlorë në datën 25 Shkurt 2025 Hotel Bologna ora 12:00
- Berat në datën 04 Mars 2025 Hotel AlBon ora 12:00
- Pogradec- Korçë në datën 13 Mars 2025 Hotel Kocibelli ora 12:00
- Kukës në datën 18 Mars 2025 Hotel Gjallica ora 12:00
- Shkodër në datën 25 Mars 2025 Hotel Golden Palace ora 11:00
- Tiranë në datën 3 prill 2025 pranë ambjeteve të AMSHC ora 11:00

Gjithashtu ftoi të gjitha OJF-të e interesuara dhe të pamundura për të qënë pjesë e takimit të dërgojnë në adresën e emailit info@amshc.gov.al të gjitha sugjerimit e tyre në kuadër të prioriteteve mbi shpalljen e thirrjes nn. 18.

Takimet u zhvilluan në një atmosferë konstruktive dhe u karakterizua nga pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve të shoqërisë civile lokale. Diskutimet u fokusuan në:

- a) Identifikimin e sfidave me të cilat përballen organizatat në terren;
- b) Nevojën për mbështetje të qëndrueshme institucionale;
- c) Rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sektorit civil dhe institucioneve publike;
- d) Sugjerime konkrete për përmirësimin e politikave mbështetëse.



Pjesëmarrësit vlerësuan organizimin e takimeve dhe shprehën interes për vazhdimësi të këtyre komunikimesh. Të gjitha gjetjet, sugjerimet apo prioritetet janë përmbledhur dhe do përfshihen në shpalljen e thirrjes nr. 18.

Mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 1 Prill 2025

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në funksionin e Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, zhvilloi në datën 1 Prill 2025 në orën 14:00 në ambjentet e Qendrës për Hapje dhe Dialog në Kryeministri, mbledhjen e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Nën drejtimin e Z. Vladimir Thano, Nënkryetar i Këshillit, dhe në prezencë të anëtarëve të qeverisë, të shoqërisë civile, dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, u mbajt mbledhja e parë kombëtare e KKSHC-së për vitin 2025.

Gjatë mbledhjes disa nga çështjet që u diskutuan ishin:

- (i) Problematikat e hasura nga shoqëria civile në kuadër të tkurrjes së burimeve financiare nga donatorët ndërkombëtarë;
- (ii) Efikasiteti i Ligjit për Sponsorizimet;
- (iii) Mbështetja financiare për shoqërinë civile



Takimet e Grupit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (GNPIE), për Kapitullin 22

Tiranë, 24 Prill 2025



Më 23 prill 2025, përfaqësues të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile more pjesë në Sallën Albanologjia të Pallatit të Kongreseve në Tiranë, ku u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (GNPIE) për Kapitullin 22, që i dedikohet politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore të BE-së. Kjo mbledhje mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve kyçe Shqiptare dhe partnerët ndërkombëtarë nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri, pjesë e tyre ishin dhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), projekti i asistencës teknike për Kapitullin 22 në Shqipëri, projekti i asistencës teknike EU4GoodGovernance dhe projekti Zvicëran “Bashki të Forta”, për të diskutuar mbi ecurinë e procesit të integrimit të Shqipërisë në kuadër të këtij kapitulli dhe hapat që duhen ndjekur më tej.

Në fjalën e tij të hapjes së mbledhjes, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe njëherazi negociatori për Kapitullin 22, z. Arbjan Mazniku, theksoi se Shqipëria ndodhet në një moment vendimtar në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian, falë punës së jashtëzakonshme të bërë deri më tani nga secili prej institucioneve të pranishme për përgatitjen e pozicioneve negociuese dhe për të avancuar në procesin e integrimit.



Në vijim, z. Hubert Perr, Drejtor i Bashkëpunimit pranë Delegacionit të BE-së në Shqipëri, në fjalën e tij rikonfirmoi mbështetjen e vazhdueshme të BE-së përmes projekteve të asistencës teknike dhe Planit të Rritjes, nga i cili Shqipëria do të përfitojë një shumë të konsiderueshme prej 922 milionë euro. Ai theksoi gjithashtu që Shqipëria do të përfitojë edhe nga fonde të asistencës IPA për të mundësuar që procesi i integritetit dhe programimit të vazhdojë me sukses.

Zv/Ministri i Financave, z. Andi Memeti, i cili është emëruar së fundmi si Autoriteti Kombëtar i Autorizuar (NAO), theksoi rëndësinë e sigurimit të standardeve të larta të kontrollit financiar dhe administrimit të fondeve në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së.

Në vijim të mbledhjes, Sekretariati Teknik prezantoi Raportin e Shqyrtimit (Screening Report) e dërguar nga Komisioni Evropian për pjesën e Kapitullit 22, duke vënë në dukje progresin e arritur dhe çështjet që mbeten për t'u adresuar.

Ekspertet e asistencës teknike të BE-së, znj. Valeria Valeri dhe znj. Victoria Primhak, ndanë përditësimet mbi Planin e Veprimit si dhe raportet e vlerësimit vetjak të institucioneve përgjegjëse lidhur me përmbushjen e kushteve mundësuese për këtë kapitull. Pjesë e diskutimeve ishte edhe planifikimi i aktiviteteve të GNPIE për periudhën maj-korrik 2025, me qëllim intensifikimin e punës ndër-institucionale në këtë fazë të rëndësishme të procesit.

Mbledhja shërbeu si një platformë e rëndësishme për të diskutuar progresin, sfidat dhe prioritetet që duhen adresuar në vijim. Të gjithë pjesëmarrësit u angazhuan për një bashkëpunim të ngushtë dhe për koordinim të qëndrueshëm ndër-institucional për të siguruar që Shqipëria të përmbushë me sukses kërkesat e Kapitullit 22. Ky angazhim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe konsolidimit të qeverisjes së mirë dhe përdorimit efektiv të fondeve Evropiane.

Takimi Tematik për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit

Tiranë, 24 Prill 2025

Takimi i Ekipit Tematik për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit

Në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë,
në dt. 24 Prill 2025,

u zhvillua takimi i radhës i Ekipit Tematik në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, i drejtuar nga Zv.Ministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta.



Në takim morën pjesë të gjitha institucionet zbatuese të strategjisë, dhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), të angazhuara për një implementim efikas dhe të qëndrueshëm të masave të parashikuara.

Diskutimet u fokusuan në çështje kyçe si:

- ◆ Ofrimi i ndihmës juridike falas për grupet vulnerabël
- ◆ Promovimi i ndërmjetësimit si mekanizëm alternativ dhe i shpejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

- ◆ Rritja e aksesit në drejtësi për viktimat e krimit

Një theks i veçantë iu dha rolit të shoqërisë civile, e cila mbetet partnere e pazëvendësueshme në rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen konkrete për viktimat.

🔊 Strategjia është vlerësuar si një arritje thelbësore në kuadër të procesit të integritetit evropian, duke reflektuar përkushtimin institucional për ndërtimin e një sistemi drejtësie më gjithëpërfshirës, efikas dhe të drejtë për të gjithë qytetarët.

AMSHC shpall Thirrjen 18 për projekt-propozime

Tiranë, 13 Maj -13 Qershor 2025

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në kuadrin e konkurrimit të hapur dhe transparent sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenet 8, 21, 22, 23, të Ligjit Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në nenet 5, 10, të VKM-së 769/2009 “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, e ndryshuar, Vendimit 02 të Bordit Mbikqyrës të datës 14/04/2025 dhe akteve nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi, në përputhje me fushën e saj të veprimtarisë, SHPALL këtë Thirrje për shprehje interesi për aplikime nga ana e OJF-ve që operojnë në Republikën e Shqipërisë.



Gjatë takimeve të zhvilluara nga përfaqësuesit e AMSHC-së dhe OJF-ve të ndryshme apo pushtetit vendor, janë prezantuar nga ana e institucionit tonë qëllimet e zhvillimit të takimeve dhe janë dëgjuar propozimet e tyre për prioritetet sipas fushës së veprimtarisë dhe në përfundim duke konsultuar në tërësi janë grupuar propozimet për prioritetet.

Nga diskutimet e shumta të bëra nga pjesëmarrësit në takime, përfaqësuesit e OJF-ve dhe grupet e tjera të interesit si dhe nga shqyrtimi i të gjithë materialit të marrë në rrugë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy), ku pjesëmarrësit listuan të gjitha sugjerimet e tyre, u arrit në përfundim se Shoqëria Civile ndeshet me problematika dhe sfida të shumta, të cilat kërkojnë zgjidhje. Duke marrë parasysh rolin e AMSHC-së në përputhje me ligjin në fuqi pasi u finalizuan takimet e programuara në kuadër të konsultimit publik.

Për të gjitha OJF-të e interesuara që përmbushin kriteret ligjore, jeni të lutur të depozitoni aplikimet tuaja për projekt-propozime sipas fushave prioritare (bashkangjitur) dhe duke depozituar dokumentacionin si më poshtë:

Fushat mbi përparësitë/prioritetet të projekt-propozimeve:

1. Qeverisja e mirë dhe Antikorrupsioni
2. Përfshirje sociale, të drejtat e njeriut dhe fuqizimi i grupeve të marginalizuara
3. Zhvillimi ekonomik, punësimi dhe inovacioni
4. Mbrotjtja e mjedisit dhe tranzicioni i gjelbër
5. Kultura, arsimi, shëndeti dhe trashëgimia

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Kosovë

Tiranë, 15 Qershor 2025

Në Tiranë, më 15 Qershor 2025, përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile morën pjesë në mbledhjen e dytë të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit të Programit IPA III Shqipëri–Kosovë. Komiteti miratoi unanimisht dokumentet kryesore, përfshirë notën konceptuale për thirrjen e parë për propozime, planin e punës për periudhën 2025–2026, si dhe planin e vizibilitetit dhe komunikimit.

Anëtarët vlerësuan përputhshmërinë e programit me prioritetet strategjike të BE-së, Agjendën e Gjelbër, Planin e Zhvillimit për Ballkanin Perëndimor dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Drejtoresha e Përgjithshme, znj. Eridana Çano, theksoi rolin udhëheqës të Shqipërisë në zbatimin e programit, si dhe angazhimin për integrim rajonal dhe zhvillim të qëndrueshëm.



- Programi synon të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar përmes zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit, turizmit të qëndrueshëm dhe rritjes së mundësive për të rinjtë. Ai përfaqëson një vizion të përbashkët për një rajon më të lidhur, më të qëndrueshëm dhe më të begatë, duke dëshmuar se me mbështetje politike, përfshirje të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është ura më e sigurt drejt integritetit evropian.

KAPITULLI VI

Bordi Mbikqyrës i AMSHC-së

Bordi mbikqyrës për të përmbushur detyrat sipas kompetencave të përcaktuara shprehimisht në ligjin Nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, gjatë vitit kalendarik 2025 ka organizuara mbledhje ku në rendet e ditës të të cilave diskutohen një sërë objektivash dhe merren vendime.

Në mbledhjen e datës 07.07.2025, Rendi i ditës, i cili u ishte komunikuar anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës paraprakisht në formë elektronike (e-mail) nga Zëvendëskryetarja, që parashtrohet për trajtim ishte si më poshtë:

1. Shqyrtimin e dokumentacionit tekniko-juridik të projekt-propozimeve dhe vlerësimeve me pikë të bëra nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ngritur pranë AMSHC-së për Thirrjen 18.
2. Miratimin e projekt-propozimeve fituese dhe miratimin e skemës të shpërndarjes të shumës së financimit me Grant.
3. Miratimin e përmbajtjes së kontratës që AMSHC si Autoritet Financues do të lidhi me Subjektet Përfituese.
4. Çdo çështje tjetër, që do të vlerësohet nga Bordi Mbikqyrës për trajtim, për ecurinë dhe efikasitetin e procedurave për Thirrjen 18.

Procesverbal Mbledhja e bordit datë 07.07.2025

Në përfundim të mbledhjes Bordi mbikqyrës doli me Vendimi Nr. 03 datë 07.07.2025 “Për miratimin e Projekt- Propozimeve Thirrja 18 dhe shumat e financimit me grant

FUSHAT MBI PËRPARËSITË/PRIORITETET TË PROJEKT-PROPOZIMEVE:

1. QEVERISJA E MIRË DHE ANTIKORRUPSIONI

- Trajnime dhe fushata për edukim ligjor dhe angazhim qytetar.
- Projekte për rritjen e integritetit dhe luftës ndaj korrupsionit në nivel lokal dhe qendror.

2. PËRFSHIRJE SOCIALE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE FUQIZIMI I GRUPEVE TE MARGJINALIZUARA

- Projekte për gra, minoritete dhe persona me aftësi të kufizuara.
- Aktivitet sportive dhe kulturore për përfshirje sociale.
- Fushata për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.

3. ZHVILLIMI EKONOMIK, PUNESIMI DHE INOVACIONI

- Trajnime profesionale për gra dhe të rinj.
- Projekte zhvillimi turizmi dhe agrobiznesi.
- Kurse edukimi digjital për grupet e marginalizuara në zonat më pak të zhvilluara.

4. MBROJTJA E MJEDISIT DHE TRANZICIONI I GJELBËR

- Fushata mbi ndryshimet klimatike dhe energjitë e rinovueshme.
- Projekte për ruajtjen e biodiversitetit dhe bujqësi e qendrueshme.
- Edukim mjedisor dhe aktivizim qytetar.

5. KULTURA, ARSIMI, SHENDETI DHE TRASHËGIMIA

- Promovimi i kultures dhe trashëgimise kulturore.
- Fushata ndergjegjesimi për shendetin mendor dhe publik.
- Aktivitet edukative dhe sportive për të rinj dhe fëmijë.

Shuma maksimale e financimit me grant për projekt-propozim është deri në 2 (dy milionë) leke dhe kohe zgjatja 6- 12 muaj.

RAPORTI
Vjetor
AMSHC
2025